

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**  
**KRYETARI**

---

**VENDIM**

Nr. 379, Datë 31. 08. 2021

**“Për përcaktimin e listës së kandidatëve me shtetësi shqiptare që do të votohen nga kineastët votues për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve”**

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për Kinematografinë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, të ndryshuar, Vendimit të Kryetarit nr. 309 Prot., datë 30.06.2021, “Për hapjen e procesit të regjistrimit të anëtarëve kineastë dhe kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021—Shtator 2023)”, si dhe Vendimit të Kryetarit nr. 366 Prot., datë 24.08.2021, “Për rihapjen e procesit të regjistrimit të kandidaturave me shtetësi shqiptare për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021—Shtator 2023)”,

**KONSTATOJ:**

Kanë paraqitur kandidaturën për anëtar me shtetësi shqiptare të KMP, shtetasit e më poshtëm:

1. Ajola Daja, producente, skenariste, regjisore;
2. Bashkim Hoxha, skenarist;
3. Gazmend Leka, regjisor;
4. Luljeta Lleshanaku, skenariste;
5. Nasi Lera, skenarist;
6. Saimir Bajo, producent, skenarist, regjisor;
7. Vjollca Dedei, producente;
8. Ylljet Aliçka, skenarist, regjisor.

Pasi studiova me vëmendje kandidaturat e paraqitura, vërej se përgjithësisht kandidaturat janë personalitete, të cilët kanë eksperiencë në fushën e

kinematografisë. Bazuar në kriteret e vendosura në takimin me Kryetarët e shoqatave të kineastëve datë 16.08.2021,

### **V E N D O S A:**

I. Të përzgjedh kandidaturat me shtetësi shqiptare, të cilët do të kalojnë në procesin e votimit nga kineastët votues, sa më poshtë:

1. Bashkim Hoxha, skenarist;
2. Gazmend Leka, regjisor;
3. Vjollca Dedei, producente;
4. Ylljet Aliçka, skenarit, regjisor.

II. Ngarkohet Drejtoria e Projekteve të bëjë njoftimet përkatëse për aplikantët.

III. Ky vendim hyn në fuqi datën e nënshkrimit të tij.

**KRYETARI**  
  
**Eduart MAKRI**

